



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/ L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008 dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari Komunës merr:

VENDIM
PËR CAKTIMIN E ZYRTAREVE MONITORUESE TË ZONËS EKONOMIKE -
PARKUT INDUSTRIAL NË QYLAGË

I. Me këtë Vendim, **CAKTOHEN**, Zyrtare monitoruese për Zonën Ekonomike në Qylagë, zyrtaret komunale si vijon:

1. Gafurr Hetemi, Zyra e Kryetarit-Sektorit për çështje pronësore-juridike,
2. Fitore Buja, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim

II. Zyrtaret e lartëcekura do të bëjnë monitorimin dhe mbajtjen e kontakteve me bizneset brenda ZE Qylagë të cilat biznese, do të vendosen në këtë zonë pas përfundimit të procedurave të konkursit publik përkatësisht nënshkrimit të kontratave me Komunën e Lipjanit.

III. Zyrtaret e lartëcekura për punën e tyre do ti raportojnë Drejtorit të Drejtoratit për Ekonomi dhe Zhvillim.

IV. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohen Drejtori i Drejtoratit për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Zyrtaret e lartëcekura.

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi 1Nr. 300/01-43505 i datës 16.08.2022.

1Nr. 020/01-2391

Lipjan, më 11.01.2024

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/ L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008 dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari Komunës merr:

VENDIM PËR CAKTIMIN E ZYRTARIT PËRGJEGJËS

I. Me këtë Vendimi, **CAKTOHET Jetmir Bytyqi** - Zyrtar për Mbrojtjen e Mjedisit në Drejtorati për Planifikim, Urbanizem dhe Mbrojtje të Mjedisit i caktohet detyra shtesë si Zyrtar përgjegjës nga Komuna për menaxhim të mbeturinave.

II. Detyrat shtesë si Zyrtar për menaxhim të mbeturinave të cilat i caktohen janë:

- Menaxhimi i punës se përgjithshme të Komunës lidhur me menaxhimin e mbeturinave,
- Ndihma për Drejtoratet kompetente në caktimin e objektivave dhe zhvillimin e planit të punës për përmbushjen e objektivave,
- Zhvillimi dhe propozimi i politikave në lidhje me menaxhimin e mbeturinave dhe higjiene komunale dhe mbikëqyrë zbatimin e tyre,
- Koordinimi i punës dhe bashkëpunimi me menaxherët tjerë në Komunë, Drejtoratin për Shërbime, Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe Drejtoratet e tjera kompetente.

III. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Shërbime, Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe Drejtorati për Planifikim, Urbanizem dhe Mbrojtje të Mjedisit.

IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëtin do të njoftohet zyrtari Jetmir Bytyqi, Drejtorati për Shërbime, Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe Drejtorati për Planifikim, Urbanizem dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi i datës 28.12.2016.

1Nr. 112/02-2388

Lipjan, 11.01.2024

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 par. 4 dhe 5 i Rregullores MF - Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare në Organizatat Buxhetore si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR PRANIMIN E PASURISË JO FINANCIARE TË KOMUNËS

Neni 1

Përbërja e Komisionit

Për pranimin e pasurisë jofinanciare të Komunës formoj Komisionin në këtë përbërje:

1. Adelina Rexhepi Sahiti, Kryesuese
2. Ramush Shala, anëtar
3. Mexhide Gashi, anëtare

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni në pajtim me Rregulloren MF -Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare në Organizatat Buxhetore, pranon pasurinë jofinanciare të Komunës dhe gjatë pranimit ka për detyrë si vijon :

1. Të verifikojë sasinë e porositur, cilësinë, llojin dhe vlerën e pasurisë jofinanciare në përputhshmëri me kontratën për urdhërblenjen.
2. Komisioni nuk duhet të pranojë pasurinë jofinanciare e cila nuk është në përputhje me kontratën dhe urdhërblenjen (mënyra e amabalazhimit, cilësisë llojllojshmërisë, plotësisë dhe marka e prodhimit).
3. Komisioni gjatë pranimit të pasurisë jofinanciare harton procesverbal dhe në rastet e mospranimit të pasurisë jofinanciare shënon edhe arsyetimin e mospranimit.
4. Mandati i këtij Komisioni zgjat deri më 31.12.2024.
5. Komisioni ka për detyrë që për çdo tre muor ti paraqes informatë me shkrim Kryetarit të Komunës për zbatimin në praktikë të këtyre detyrave .

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës ndërsa me kopjen e këtij Vendimi të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/01-759
Lipjan, më 04.01.2024

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 21 të Rregullores MF-NR.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jofinanciare në organizatat buxhetore si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E PASURISË JOFINANCIARE

Neni 1
Formimi i Komisionit dhe përbërja

Me këtë Vendim, formohet Komisioni për vlerësimin e pasurisë jofinanciare të Komunës (në vazhdim të tekstit Komisioni) në këtë përbërje:

1. Shehadije Ibrahim, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, Kryesuese
2. Brahim Duriqi, Drejtorati për Arsim, anëtar
3. Albulena Gashi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtare
4. Valdete Muji, Sektori për përfaqësim dhe çështje ligjore, anëtare
5. Besmir Retkoceri, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtar

Neni 2
Detyrat, përgjegjësitë dhe mandati Komisionit

Përgjegjësitë e Komisionit janë:

1. Vlerësimi i pasurive të dëmtuara;
2. Vlerësimi i kërkesave për tjetërsim të pasurive;
3. Prezantimi i dëshmive për vlerësimin e pasurisë;
4. Përgatitja e raportit për pasurinë jofinanciare që duhet të largohet nga përdorimi

Komisioni do të kryej detyrat në pajtim me e dispozitat e Rregullores MF-NR.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jofinanciare në organizatat buxhetore .

Komisioni ka mandat të beje vlerësimin e pasurisë jofinanciare, përkohësisht më së largu me datë 31.12.2024.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës ndërsa me kopjen e këtij Vendimi të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/01-782
Lipjan, më 04.01.2024

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Akmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT

Neni 1
Përbërja

Formohet Komisioni për monitorimin e kontratëve për dhënie në shfrytëzimi afatëgjatë të pronës komunale, në këtë përbërje:

1. Gafurr Hetemi, Zyra e Kryetarit-Sektorit për çështje pronësore-juridike, kryesues
2. Ilir Shala, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, anëtar
3. Fatbardha Shurdhiqi, Drejtorati për Infrastrukturë, anëtare

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

1. Komisioni ka për detyrë të monitorojë dhe mbikqyrë zbatimin e kontratave që jepen nga komuna për shfrytëzim afatëgjatë të pronës komunale, komisioni duhet të raportojë te Kryetari i Komunës në baza gjashtë (6) mujore, komisioni detyrat do t'i kryejë në bazë të dispozitave ligjore në fuqi që lidhen për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale.
2. Punët teknike administrative për komisionin do të kryhen nga Sektorit për çështje pronësore-juridike dhe Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim.

Neni 3
Hyrja në fuqi

1. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëtin do të njoftohen kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi 1Nr.463-7349 i datës 10.02.2022

1Nr 020/01-2387
Lipjan, më 11.01.2024

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Rregullores MF -NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe nenve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES

Neni 1
Përbërja

Me këtë Vendim formohet Komisioni vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve për organizimin e aktiviteteve të ndryshme rinore, kulturore dhe rekreative në rastin e "17 Shkurtit" ditës së Pavarësisë së Kosovës, sipas thirrjes publike Nr.1-453/01-841 të datës 04.01.2024, në përbërje si vijon:

1. Ramiz Gashi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryesues
2. Albulena Gashi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
3. Laureta Ahmeti, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare
4. Euro lind Bytyqi nga OJQ-të, anëtar
5. Argjend Reçica, nga shoqëria civili në cilësinë e ekspertit të jashtëm, anëtar dhe
6. Uran Qeriqi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtare rezerv

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni do të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e të gjitha aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve organizimin e aktiviteteve të ndryshme rinore, kulturore dhe rekreative në rastin e "17 Shkurtit" ditës së Pavarësisë së Kosovës, që kanë aplikuar konform Thirrjes publike për aplikim Nr.1-453/01-841 të datës 04.01.2024, të shpallur nga Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sport, Komisioni do t'i kryen detyrat konform dispozitave të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohen Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sport, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

INr. 020/04-5781
Lipjan, më 29.01.2024

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/ L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Nenit 25 të Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (Gazeta Zyrtare nr. 19, datë 21.07.2022), Udhëzimeve për përpilimin dhe zbatimin e planeve të integritetit, të përcaktuara me Metodologjinë për Planet e Integritetit, të miratuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari Komunës merr:

VENDIM

I. MIRATOHET Plani i Integritetit (2024-2026) i Komunës së Lipjanit i hartuar nga Grupi Punues, i caktuar me Vendimin Nr.1-020/01-66397 të datës 01.12.2023.

II. Me këtë Vendim znj. Linda Shahini Zyrtare për Integritime Evropiane në Drejtoratin për Ekonomi dhe Zhvillim, caktohet person përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Planit të Integritetit të Komunës së Lipjanit 2024-2026.

III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

Arsyetim

Ky vendim nxirret me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore të përcaktuara me Ligjin Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (Gazeta Zyrtare nr. 19, datë 21.07.2022), në raport me detyrimet e administratës qendrore dhe agjencitë e pavarura, si dhe autoritetet komunale për miratimin e Planeve të Integritetit.

Në kuadër të kësaj, sipas udhëzimeve për përpilimin dhe zbatimin e planeve të integritetit të Metodologjisë për Planet e Integritetit, të miratuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 22.01.2024 Komuna e Lipjanit nxjerr vendim për miratimin e Planit të Integritetit, të hartuar nga grupi punues, i caktuar me Vendim Nr.1-020/01-66397 të datës 01.12.2023, të theksuar si në pikën I të dispozitivit të Vendimit.

znj. Linda Shahini Zyrtare për Integritime Evropiane në Drejtoratin për Ekonomi dhe Zhvillim sipas pikës II të dispozitivit të këtij vendimi caktohet person përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Planit të Integritetit, i cili monitoron procesin sipas planit të integritetit, zbatimin e masave të përmirësimit nga institucioni, përgatit treguesit për vlerësimin e efikasitetit dhe vlerësimin e rezultateve të masave të propozuara për përmirësimin e integritetit.

Nga ajo çfarë u theksua në arsyetim, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi iu dorëzohet:

- Anëtarëve të grupit punues,
- Personit përgjegjës,
- Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

INr. 112/02-5043

Lipjan, 24.01.2024

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 13 të Rregullores për ndarjen subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, nenit 1 të Rregullores 15Nr.011-15426 të datës 17.03.2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, Vendimit të Kuvendit të Komunës për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Lipjanit 15Nr.400/01-16372 të datës 31.03.2023 si dhe Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023, Kryetari i Komunës nxjerr:

VENDIM

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR SUBVENCIONIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT

Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **9,240.00€**, (nëntë mijë e dyqindë e katërdhjetë euro) Bashkësisë Islame dega në Lipjan, sipas kërkesës së tyre Nr.1-400/01-1362 e datës 09.01.2024, për subvencionimin e shërbimeve të varrimit për 33 raste të vdekjes, të cilat kanë ndodhur në muajin dhjetor të vitit 2023 me nga 280 euro për secilin rast $33 \times 280 = 9,240.00€$, të cilat shërbime kryhen nëpërmjet BI - dega në Lipjan në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2024, pozicioni buxhetor - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës në xhirollogarinë bankare të Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan nr.1719200019037882 në NLB.

Neni 3

Obligimet e Këshillit të Bashkësisë Islame rreth kryerjes së shërbimeve të varrimit, afatet e raportimit, dokumentacioni dhe çështje tjera që ndërlidhen me obligimet e ndërsjella mes palëve janë të përcaktuara me dispozitat e Marrëveshjes së cekur në nenin 1 të këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit të Komunës.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Këshilli i Bashkësisë Islame i Kosovës dega në Lipjan.

1Nr.400/01-1362
Lipjan, më 09.01.2024

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë nr.03/L-048, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.27 e datës 03 qershor 2008 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr

VENDIM

MBI PËRCAKTIMIN E POZICIONEVE PËR FURNIZIM ME KARTELA MBUSHËSE PËR TELEFONA MOBIL PËR VITIN 2024

I. Me këtë Vendim për vitin 2024, përcaktohet shuma mujore e mbushjeve për telefonat mobil për përdorim zyrtar për bartësit e funksioneve në vijim:

Nr	Funksioni	Nr i Kryersve	Shuma mujore
1.	Nënkryetarët e Komunës	2	30 €
2.	Kryesuesi i Kuvendit	1	20 €
3.	Drejtorët e Drejtorateve	13	20 €
4.	Drejtor i QKMF-së në Lipjan	1	20 €
5.	Drejtor i Qendrës për punë Sociale në Lipjan	1	20 €
6.	Zëdhënës i Komunës	1	20 €
7.	Inspektor i Ndërtimtarisë	2	10 €
8.	Inspektor i Trafikut	2	10 €
9.	Inspektor i Mjedisit - ambientit	1	10 €
10.	Inspektor i tregut	2	10 €
11.	Shef i Kabinetit të Zyrës së Kryetarit të Komunës	1	10 €
12.	Shef i Zyrës Lokale për Komunitete	1	20 €
13.	Shofer i Kryetarit të Komunës	1	10 €
14.	Asistente e Kryetarit të Komunës	1	10 €
15.	Numri Kujdestar në Qendrën për punë Sociale	1	10 €
16.	Menaxher të projekteve- kontrateve (Drejtorati për Infrastrukturë)	2	10 €
17.	Menaxher të projekteve-kontratave Drejtorati për Shërbime Publike Mbrojtje dhe Shpëtim	4	10 €
18.	Menaxher në Shtëpinë e Komunitetit të personave me aftësi të kufizuara në Lipjan	1	10 €

II. Pagesat për mbushje telefonike do të bëhen nga kategoritë buxhetore të pozicioneve mallra dhe shërbime të funksioneve të cekura përkatësisht Drejtorateve përkatëse për çdo muaj të punës .

III.Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin të njoftohen: Drejtorati për Buxhet dhe Financa, Drejtorati për Prokurim Menaxheri i kontratës për furnizim me mbushje elektronike dhe bartësit e funksioneve të cekura në pikën 1 të këtij Vendimi.

INr 030/k-1192
Lipjan, më 05.01.2023

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë nr.03/L-048, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.27 e datës 03 qershor 2008 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr

VENDIM
MBI PËRCAKTIMIN E SHUMËS SË SHPENZIMEVE TË REPREZENTACIONIT PËR
POZICIONET E PUNËS

I. Me këtë Vendim përcaktohet shuma mujore e të drejtës për shfrytëzimin e reprezentacionit për vitin 2024, për pije për vizitorët në Zyrën e Kryetarit të Komunës e cila do të jetë varësisht prej nevojës dhe arsyeshmërisë dhe pozicionet tjera si në vijim:

Nr.	Pozicioni i punës	Numri i kryersve	Shuma mujore
1.	Kryetari i Komunës	1	E palimituar ,varësisht prej nevojës dhe arsyeshmërisë
2.	Nënkryetarët e Komunës	2	40 €
3.	Kryesuesi i Kuvendit	1	30 €
4.	Drejtorët e Drejtorateve Komunale	13	30 €
5.	Drejtori i QKMF-së - Lipjan	1	30 €
6.	Drejtor i QPS-së Lipjan	1	30 €
7.	Shef i Kabinetit të Zyrës së Kryetarit të Komunës	1	30 €
8.	Zëdhënës/e i Komunës	1	30 €
9.	Shef/e i Zyrës Lokale për Komunitete	1	20 €

II. Shuma e përcaktuar në pikën 1 të këtij Vendimi do të shfrytëzohet në zyrën e Kryetarit të Komunës, Nënkryetarëve, Drejtorëve të Drejtorateve Komunale, Drejtorit të QKMF-së, Drejtorit të QPS-së, Shefit të Kabinetit të Kryetarit të Komunës, Zëdhënësit/es të Komunës dhe Shefit të Zyrës Lokale për Komunitete për reprezentacion për vizita zyrtare .

III. Pagesa për shfrytëzimin e reprezentacionit do të bëhen nga kategoria buxhetore - pozicioni mallra dhe shërbime të Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe Drejtorateve përkatëse.

IV.Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin të njoftohen: Drejtorati për Buxhet dhe Financa , Drejtorati për Prokurim dhe bartësit e funksioneve të cekura.

1Nr. 400/01-787

Lipjan, më 04.01.2024

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë nr.03/L-048, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.27 e datës 03 qershor 2008 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr

VENDIM
MBI PËRCAKTIMIN E DREJTËS SË SHFRYTËZIMIT TË REPREZENTACIONIT

I. Me këtë Vendim përcaktohet e drejta për shfrytëzimin e reprezentacionit për pije për vitin 2024 për anëtarët e Kuvendit të Komunës dhe trupat tjerë të kuvendit të themeluar me vendime të Kuvendit të Komunës..

II. E drejta e shfrytëzimit të e reprezentacionit e cekur në pikën I të këtij Vendimi do të shfrytëzohet gjatë mbajtjes së takimeve - seancave.

III. Pagesa për shfrytëzimin e reprezentacionit do të bëhen nga kategoria buxhetore - pozicioni : mallra dhe shërbime të planifikuara për Kuvendin e Komunës.

IV.Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin të njoftohen: Drejtorati për Buxhet dhe Financa , Drejtorati për Prokurim dhe Kryesuesi i Kuvendit Komunal .

1Nr. 400/01-771

Lipjan, më 04.01.2024

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 6 të Rregullores për transportin e udhëtarëve me automjete taksi Nr.15-345/02-33605 të datës 30.06.2023 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr

VENDIM

PËR SHPALLJEN E KONKURIT PËR DHËNIEN E LICENCAVE PËR TRANSPORTIN E
UDHËTARËVE ME AUTOMJETE TAKSI

Neni 1

Të shpallet Konkursi për dhënie e licencave për transportin e udhëtarëve me automjete taksi në Komunën e Lipjanit

Neni 2

Konkursi të shpallet në faqen elektronike të Komunës dhe në një gazetë ditore.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim i Komunës së Lipjanit.

1Nr. 346/02-4984

Lipjan, më 24.01.2024

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit INr.110-78095 i datës 24.12.2021 , Ligjit nr.05/L-020 për Barazi Gjinore duke u bazuar në shkresën e Zyres për Barazi Gjinore INr.115/01-2703 e datës 12.01.2024, Kryetari i Komunës merr :

VENDIM

1. Formohet grupi punues për hartimin e Planit të Veprimit për Barazi Gjinore në Komunën e Lipjanit, në përbërje prej:
 1. Diamant Bytyqi -Nënkryetar i Komunës ,Kryesues
 2. Hasan Luma ,NJDNJ-zyrtar për Barazi Gjinore ,anëtarë
 3. Valdete Muji – Zyra Ligjore ,anëtare
 4. Xhevahire Zeqiri –Sektori për Përsoneel ,anëtare
 5. Linda Shahini –Zyra për Integritim Evropiane ,anëtare
 6. Jalldyze Gashi Kallaba - Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm, Mbrojtje dhe Shpëtim ,anëtare
 7. Albert Mustafa - Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale ,anëtarë
 8. Teuta Berisha - Drejtorati për Arsim ,anëtare
 9. Pranvera Krasniqi - Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport ,anëtare
 10. Makfirete Shamolli – Qendra për Punë Sociale ,anëtare
 11. Laureta Ahmeti - Drejtorati për Buxhet dhe Financa ,anëtare
2. Grupi punues ka për obligim të përpiloj draftin e planit të veprimit për Barazi Gjinore në përputhje me dispozitat e ligjit Nr.05/020 për Barazi Gjinore në Komunën e Lipjanit.
3. Komisioni për punën e tij do të përpiloj raport me shkrim ,me anë të së cilit do të raportoj te Kryetari i Komunës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohet Kryesuesi dhe anëtarët e tjerë të grupit punues.

INr.115/01-2703
Lipjan, më 12.01.2024

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

